

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të rënda–me gjyqtaren Shadije Gërguri me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Arianit Mahmutaj në çështjen penale kundër të akuzuarit Xh.H. për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.nr.885-3/10 të dt:10.01.2011, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, verbalo-publik me në prezencën e të akuzuarit Xh.H. me mbrojtësin av.A.S. sipas detyrës zyrtare, dhe prokurorit të shtetit Ilaz Beqiri, me dt: **20.07.2016** publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI

XH.H. i biri i Sh., dhe nënës F., e gjinisë M., i lindur me dt: *data e lindjes...*, në në L., ku dhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Më dt. 01.10.2010 rreth orës 12;30 min, në Lipjan në aferësi të T., pas një mosmarrëveshje me të dëmtuarin S.B. se kinse pse nga kamionët e tij dikush nga personat ne kamionetë e kishin ngacmuar motrën e të pandehurit, e në këtë rast i pandehuri Xh.H. i bërtet të dëmtuarit që ta ndal kamionëten dhe posa zbret i dëmtuari, i pandehuri nxjerr nga brezi revolen e kal. 6.35 mm me nr. serik 250559, të cilën e ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim pa leje valide për mbajtjejen e autorizuzr te armëve, ashtu që revolen ia drejton të dëmtuarit më qëllim te frikësimit, por në këtë moment ndërhyne motra e të pandehurit e cila e qetëson situaten më ç’rat i dëmtuari paraqet rastin në polici,-

-me këtë ka kryer vepën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve: 2,3,4,17,21,41,42,43,45, 62,73,74, 75,76 të KPRK-së dhe nenit 365, 450 dhe 463 të KPPRK-së të akuzuarin e:

GJYKON

ME DËNIM BURGU ne kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh , pas plotëfuqëshmërisë së këtij aktgjykimit .

Konform nenit 62 parg 2 nënparg.2.7 të KPRK-së ndaj të akuzuarit i shqiptohet edhe

DËNIMI PLOTËSUES: me të cilin dënim Të akuzuarit Xh.H. i konfiskohet revolja të kalibrit 6.35mm më numër serik 250559.

OBLIGOHET: i akuzuari qe gjykatës te ia kompenzojne shpenzimet e procedures penale sipas fletes definitive mbi shpenzimet, ndërsa ne emer te paushallit gjyqesor te paguaje shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, e te gjitha ne afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërise se këtij aktgjykimi.

I Dëmtuari S.(H.)B., për realizimin e kërkesën pasurore-juridike udhëzohet ne kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda ka ngritur aktakuzë PP.nr.885-3/10 të dt.10.01.2011, kundër të akuzuarit Xh.H. për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestarë me datën 20.07.2016 dhe pasi që i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPPRK-së, ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën, nuk ka nevojë për shënim shtesë dhe pasi i ipet mundësia që të pranoj, ose mos e pranoj fajësinë lidhur me veprën penale që i vëhet në barrë, i akuzuari në kuptim të nenit 248 të KPPRK-së, deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza nga ana e prokurorisë. Prokurori i shtetit pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit .

Gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë pasi që u bind se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht dhe pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore , ose gabime faktike.

Duke marrë parasysh se pranimi i fajësisë është arritur në shqyrtimin fillestarë , konform nenit 248 par.4 të KPPRKsë, Gjykata pa fjalë përfundimtare, pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe pasi që bindet se janë vërtetuar faktet lidhur me pranimin e fajësisë, vazhdoi me shqiptimin e denimit, duke marrë parasysh se i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje direkte, duke qenë I vetëdijshëm për veprën e vet dhe e ka dashur kryerjen e saj.

Me rastin e përcaktimit të denimit Gjykata pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit, kështu që ndaj të akuzuarit morri parasysh pranimin e fajësisë dhe pendimin e thëllë, si rrethanë posaçërisht lehtësuese dhe gjendjen e tij të dobët ekonomike si dhe sjelljen e tij korrekte gjatë seancës gjyqësore. Nga rrethanat rëndësuese asgjë nuk gjeti. Andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtorë dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke I aplikuar dispozitat ligjore për zbutjen e denimit, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe i njëjti do të shërbej si preventivë individuale dhe gjenerale dhe

parandalim se në të ardhmën nuk do të kryen vepra penale duke ndikuar në rehabilitimin e tij.

Gjykata është e bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit siç është rregulluar me nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi dënimin plotësues është marrë konform nenit 62 par.2 nën.par.2.7 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marr konform dispozitave të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vëndimi për udhëzimin e të dëmtuarit ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, gjykata e morri konform nenit 463 par.2. te KPPRK-së.

Andaj, nga sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij atkgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.482/13, të dt. 20.07.2016

Procesmbajtësi:
Arianit Mahmutaj

Gjyqtarja:
Shadije Gërguri

Mbrojtësi i të akuzuarit dhe Prokurori i qështjes , kanë hequr dorë nga e drejta për ankesë në aktgjykim.